



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DROPULL
KESHILLI BASHKIAK

Nr. 946 Prot

Jorgucat, 26.05.2026

PROCESVERBALI MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK DROPULL DATË 26.05.2026

Sot ne datën 26.05.2026 ora 10.00,u mbajt mbledhja e radhes e Keshillit Bashkiak Dropull ne sallën e mbledhjeve të Keshillit Bashkiak.Mbledhja është live.

Këshilltarë të pranishëm janë: Donika Bauçi,Kostando Ksera,Aleksander Boboli,Panajot Lulo,Angjeliqi Praso,Eljona Mano,Alketa Basho,Kristaq Frango. Kristo Varsami, Marjeta Xhumba, Fotaq Zhonga. Pandeli Kuremeno ,Maksi Qendro, Elefteria Karaxha,

Mungesa:Zhaneta Dralo, Kostandina Doko,Anastas Iso, Mirela Koça, Kristaq Pano, Valentina Ruxho, Efthalia Beshiri .

Kryetarja e keshillit kryesuesi i mbledhjes.

Pjesmarres nga ana e Bashkise Dropull:Kryetari i Bashkisë z. Dhimitraq Toli,nen/kryetar z. Dhefto

Drejtorat:Arjan Tusha ,Kleopatra Karaxha, Evi Pasxo , Grigor Dushi,Jani Panajoti,Lindita Xhuba, juristi Elidon Papazisi,Pergj te zyrove Lefter Nasto,Janulla Ngjelo, Jeorgja Vasili,pergj buxheti Kristaq Lengo,specialiste buxheti Babameto,specialiste sherbimeve Anthi Nika,Albert Kasi nga Bashki te forta.

Gjithashtu ne mbledhje marrin pjese nxenes nga shkolla e Mesme Dervician dhe Bularat per te ndjekur si zhvillohet mbledhja e Keshillit.

Kourumii domosdoshem eshte i pranishem ne salle ,mbledhja deklarohet e hapur nga kryesuesi i mbledhjes.Kryetarja e Keshillit pasi pershendet nxenesit dhe gjithe te pranishmit i jep fjalen kryetarit te Bashkise .

Kryetarii Bashkise merr fjalen duke pershendetur nxenesit .Ifalenderon qe jane pjese ekesaj mbledhje dhe jane te mirepritur te vijne ne cdo mbledhje te diskutojne dhe te ngrene problemet e tyre dhe ne qoftese duan te bejme dhe nje mbledhje keshilli vetem me nxenesit .

Keshilltari Pandeli Kuremeno : Mirseardhjen e nxenesve mqs. Jam nga fshati Bularat u lutem nxenesve , per kendin e lojrave ne shkollë te cilen e filluan si fshat dhe Bashkia me M.A e mbaroi bashke me shkollen. Ju lutet nxenesve te shkollës se Mesme te mos e shkaterojne se deri me sot jane shkateruar te gjitha stolat, Kerkojme ta mirembani këndin e lojrave.

Kryetarja e Keshillit fillon me rendin e ditës :

1. Projekt-Vendim “ Për miratimin e përfituesve te fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar të ndihmes ekonomike per muajin Maj 2026

2. Projekt-Vendim "Për rishqyrtimin e vendimit nr.22 date 30.04.2026" Per miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për emergjencat civile dhe shtesave buxhetore, për vitin 2026".
3. Projekt-Vendim "Per miratimin e shtesave te te ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore.
4. Projekt-Vendim "Për miratimin e Programit të Trasparencës në Bashkinë Dropull".
5. Projekt-Vendim "Per Për Miratimin e Numrit dhe te Nivelit te Pagave të Punonjësve Sezonal për Menaxhimin e Liqeneve, për vitin 2026».
6. Projekt-Vendim "Per marrjen ne shfrytezim te godines se ish shkolles Goranxi,me qellim shderrimin e saj ne Qender Kulturore dhe Seli Komunitare te "Dropull Festival".
7. Projekt vendim "Per miratimin e kerkeses te kryetarit te fshatit Bularat per vendosje busti te dy mjekeve te njohur "Aleksandros Kalivopullos" dhe "Ahilea Boti"ne fshatin Bularat."
8. Raporti I Performances 2025".
9. Informacion per raportin e monitorimit te zbatimit te buxhetit per 4-mujorin e pare te vitit 2026.
10. Informacion nga Drejtoria e Ujesjellesit mbi situaten e furnizimit te popullates me uje te pijshem dhe cilesia e menaxhimit te ketij sektori te rendesishem.
11. Informacion nga Drejtoria e ujerave,pyjeve,Livadheve dhe kullotave mbi gjendjen dhe gadishmerine e kanaleve vadites.
12. Informacion nga Sektori i Mbrojtjes nga Zjarri per masat e marra dhe gatishmerine per teperballuar temperaturat e larta qe mund te shkaktojne zjarret gjate periudhes se veres .

Miratojme procesverbalin e muajit Prill .

Vazhdojme me rendin e dites

1. Projekt-Vendim " Për Miratimin e listës së përfituesve dhe masës mujore të përfitimit nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar të ndihmës ekonomike, për familjet dhe individët në nevojë, për muajin Maj 2026, sipas tabelave bashkangjitur "

Relaton Kleopatra ,drejtore e ndihmes Sociale .Gjithsej per muajin Maj 2026 jane 84 familje me nje fond 266.956 lek megjithe fondin 6%,mbi fondin e kushtezuar te ndihmes ekonomike.

Hedhim ne vote projekt vendimin ,Votojne 14 keshilltare pro,kundra ska ,0 abstenim. **Pra miratohet**

2. Projekt-Vendim "Për rishqyrtimin e vendimit nr.22 date 30.04.2026" Per miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për emergjencat civile dhe shtesave buxhetore, për vitin 2026".Relaton P/buxhetit z. Lengo .Per arsye moskonfirmimi te vendimit nr.22 date 30.04.2026 "Per miratimin e perdorimit te fondit te kushtezuar te buxhetit te shtetit per emergjencat civile dhe shtesave buxhetore 2026 nga prefekti i Qarkut per arsye te mos zbatimit plotesisht ,te VKM nr.414 date 08.07.2021akordimi i ndihmes financiare jipet vetem per objekte banimi dhe nuk mund te perdoret per objekte biznesi apo te tjera qe nuk sherbejne si banese.Ne keto kushte jemi te detyruar ta rishqyrtojme dhe nje here vendimin e keshillit duke anuluar perdorimin e fondit te kushtezuar te buxhetit te shtetit per emergjencat civile, pert Elefteria Lako(Kasolle) dhe Valentina Ruxho(biznes hotel)Shumat e lekeve do te shperndahen vetem per objektet e banimit te permendurat ne vendimin e keshillit nr.63,date 27.11.2025"Per nje ndryshim ne vendimin nr.41,date 29.08.2025"Per konstatimin dhe vleresimin e demeve persubjektet e evidentuara nga grupi i konstatimit i ngritur prane bashkise Dropull,te shkaktuara nga zjarri masiv i dates

24.07.2025, ne fshatin Kakavi. Duke vleresuar kushtet social-ekonomike dhe duke ruajtur perparesine kerkojme mbulim diferences per demin i dates 24.07.2025 te shtëpisë Hristo Karamano dhe mbulim te shpenzimeve per demin nga zjarri te shtepise se z. Andon Niko ne fshatin Sotirë. pjesa tjetër ne investimin "Riparim i demeve ne objektin "Mbrotje nga përroi i Selosë dhe ne sgmentetrrugore Likomil-Selo-Klishar. Kete vendim do ta ndajme shtesat buxhetore vendim me vete .

Boboli Ka mundesi nga te ardhurat e Bashkise t ' tu japim nje ndihme ketyre te fundit qe pesuan deme nga zjarri ,Lengo vedimet me kosto financiare miratohen nga kryetari i Bashkise.

Pando do te doja te diskutoja per rrugen e Policanit , nje pjese rruge ne hyrje te doganes Dhrimadhes 15 m te vendoset ne emergjence dhe e dyta per uren e Glines se do na vij dimri dhe do bllokohen prape fshatrat. Pergjigjet kryetari i Bashkise.

Per mbledhjen e ardhshme per demin nga zjarri ne hotel dhe kasollen. te diskutohet dhe ta sjellim ne mbledhjen e ardhshme.

Kryetarja keni pyetje Hedhim në vote projekt vendimin Votojne 14 pro kundra ska ,0 abstenim.

Pra miratohet.

3. Projekt Vendim "Per miratimin e shtesave te te ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore.

Lengo Na eshte çelur ne Degen e Thesarit Gjirokaster ,vlera e miratuar prej 6.555.450 lek e cila do duhet perkatesisht, te shtohen te ardhurat e Bashkise tek kapitulli 2 (grante te huaja) por edhe tek shpenzimet. Nga granti i bazuar ne performance , me burim financim te huajte shtohen te ardhurat 6.555.450, te shtohen shpenzimet per Planin e mbareshtimit te ekonomise pyjore Dropull i Siperim. Kryetarja hedhim projektvendimin ne votim votojne 12 pro, kundra ska, 2 abstenim. Pra miratohet

4. Projekt Vendim "Për miratimin e Programit të Trasparencës në Bashkinë Dropull". Relaton Jona Merkuri per Programin e transparences sipas lidhjes 1 bashkelidhur qe informacioni te behet publik sipas fushave ne tabele.

Kryetarja hedhim ne vote projekt vendimin Votojne 12 pro ,kundra ska, 2 abstenim. Pra miratohet.

5. Projekt-Vendim "Per Për Miratimin e Numrit dhe te Nivelit te Pagave të Punonjësve Sezonal për Menaxhimin e Liqeneve, për vitin 2026" relaton Jona Merkuri Ne numrin total te punonjesve shtohen 5 pozicione pune te tjera Punonjes sezonal per menaxhimin e liqeneve me kohe te percaktuar tremujore 2 punonjes dhe ne zjarrfikes 3 pozicione pune.

Hedhim ne vote projekt vendimin .Votojne 12 pro, kundra ska, 2 abstenim. Pra miratohet.

6. Projekt-Vendim "Per marrjen ne shfrytezim te godines se ish shkolles Goranxi, me qellim shderrimin e saj ne Qender Kulturore dhe Seli Komunitare"

Kryetarja pasi morem kerkesen kemi bere dhe degjese publike ne fshain Goranxi ku moren pjese 28 veta 10 bura dhe 18 gra, qytetare ,keshilltare dhe kryesia e fshatit.

Drejtore Kultures zonj. Evi Pasho flet per kerkesen per godinen e shkolles ne Goranxi ,plani i veprimit perfshin Rikostruksion te godines, gjallerimin e jetes kulturore ,abjenti do te sherbeje si nje qender multifunksionale, ku do te organizohen seminare ,ekspozita, aktivitete edukative per te rinjte.

Promovim turistik, punesim.

Kryetarja : Kalojme ne votim. Votojne 14 keshilltare pro ,kundra ska 0 abstenim

7. Projekt vendim "Per miratimin e kerkeses te kryetarit te fshatit Bularat per vendosje busti te dy mjekeve te njohur "Aleksander Kalivopulli" dhe "Arqilea Boti" ne fshatin Bularat."

Kryetarja e Keshillit flet per kerkesen e kryetarit te fshatit Bularat per te cilen kemi bere dhe degjese publike ku moren pjese 52 qytetare. Fjalën e merr keshilltari Pandeli Kuremeno ku flet per biografinë vepren dhe jetën e doktorëve nga fshati Bularat dhe kërkon miratimin për vendosjen e busteve të dy mjekëve me autoritet shkencor në vendlindjen e tyre .

Kryetarja : Kalojme në votim. Votojne 14 keshilltare pro ,kundra ska 0 abstenim

Pra miratohet

8.Raporti I Performances 2025”.Raportin e performances për vitin 2025 e paraqet Jona Merkuri. Diskutime :Kuremeno diskuton për :Ne paragrafin për vaditje keni marrë masa për të pastruar kanalet një pjesë mbi liqenin Bodrishtes.Pergj. Dushi : Jane marrë masa për të pastruar kanalet dhe një pjesë mbi liqenin e Bodrishtes u moren masa për rehabilitimin e kanalit. Ne paragrafin për shërbimet në Bularat për varrezat , të zgjidhet mosmarveshja midis kryesise se fshatit dhe të kishes.

Kostando: Ne performancën e vitit 2025 nuk pasqyrohet në asnjë paragraf, për kulturën dhe turizmin.

Boboli :Për turistiko odhigo ku keni arritur.

9. Raporti i monitorimit 4mujor relaton z. Lengo.Ne raportin që kemi përpara është paraqitur dhe ndryshimet që janë bërë buxhet.Te ardhurat si katërmujor janë realizuar nëmasën 21.513,5mijë leke ,ose 27.7 % të planit vjetor të të ardhurave.Ne lidhje me shpenzimet në total janë realizuar 102.175 mijë leke.

10. Informacion nga Drejtoria e Ujesjellesit mbi situatën e furnizimit të popullatës me ujë të pijshëm dhe cilësia e menaxhimit të këtij sektori të rëndësishëm.

Relaton p/ujesjellesit Z. Mihal Kaliva për gjendjen e tanishme të furnizimit me ujë .Gjendja e tanishme është kënaqshme Dropulli merr 24 ore ujë nga ujesjellesi i Selckes.Kishim demë për shkak të kohës së keqe por i kemi ndrequr .

11 Informacion nga Drejtoria e ujerave,pyjeve,Livadheve dhe kullotave mbi gjendjen dhe gadishmerinë e kanaleve vadites. Relaton drejtori pyjeve,Livadheve dhe kullotave .

12.Informacion nga Sektori i Mbrojtjes nga Zjarri për masat e marra dhe gatishmerinë për të përballuar temperaturat e larta që mund të shkaktojnë zjarret gjatë periudhës së verës Relaton P/MZSH z. Alqi Kosta.

Kryetar i Keshillit

DONIKA BAUÇI

Procesverbali përmban 5 faqe

Sekretar i Keshillit

Urania Kuremeno





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DROPULL
KESHILLI BASHKIAK



LIST PREZENCA E TAKIMIT MË DATË: 26.05.2026, ORA 10:00

- 1- Kristo Varsami
- 2- Aleksandër Boboli
- 3- Maksis Qendo
- 4- Folqaz Zhanos
- 5- Pranxhjet Lulo
- 6- Angelipi Praso
- 7- Eljona Mano
- 8- Maryeta Xhumbro
- 9- Alketa Bashe
- 10- Kostando Ksera
- 11- Lendeli Kurumeno
- 12- Sonina Gous
- 13- Kristonj Prereng
- 14- Ceflerin Kurumeno

Gezartode
Mecur Kurumeno